



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURES
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 387 Prot.

Tiranë, më 16.03 2018

VENDIM Nr. 48, datë 08.03.2018

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 30, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.3, datë 08.03.2018, pasi shqyrtoi Kërkesën për miratim të projektit të segmentit të rrugës "Fetah Bllaca" pjesë e projektit "Rikualifikim, Rruga "Aleksandër Goga" nga Sheshi Liria-Muzeu i Dëshmorëve" në zonë arkeologjike "A" të qytetit të Durrësit- subjekti Bashkia Durrës,

VENDOSI:

1. Të miratojë projektin e segmentit të rrugës "Fetah Bllaca" pjesë e projektit "Rikualifikim, Rruga "Aleksandër Goga" nga Sheshi Liria-Muzeu i Dëshmorëve" në zonë arkeologjike "A" të qytetit të Durrësit- subjekti Bashkia Durrës.
2. Subjekti "Bashkia Durrës" duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili duhet të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit për projektin e segmentit të rrugës "Fetah Bllaca" pjesë e projektit "Rikualifikim, Rruga "Aleksandër Goga" nga Sheshi Liria-Muzeu i Dëshmorëve", si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë subjekt.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.

4. Të hartohet nga DRKK Durrës në bashkëpunim me projektuesin dhe Bashkinë Durrës, një projekt për sistemimin e zonës së Forumit Bizantin, i cili pozicionohet pranë segmentit të rrugës "Fetah Billaca", si pjesë e projektit të kësaj rruge.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

MINISTRE



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO